



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:169111

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05815991

KPPP.nr. 1240/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.SH.T “KRISTAL-B”, me numër unik identifikues 810415382, dhe seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Lajqi, avokat nga Peja, kundër debitorit “Klan Kosova” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810795297 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blinera Osmani, avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 75/23, i lejuar me datë 29.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, me seli në Pejë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 11.06.2024 në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse, jashtë seancës, me datë 12.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit “Klan Kosova” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810795297 dhe seli në Prishtinë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 75/23, i lejuar me datë 29.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, për pjesën e detyrimit në shumë prej EUR 3,000.00 dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Klan Kosova” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810795297 dhe seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 75/23, i lejuar me datë 29.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, për borxhin në lartësi prej EUR 83,191.10 dhe kumatën ligjore prej 8 % në këtë pjesë të detyrimit, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 013121036-1 e datës 31.01.2021; Faturës nr. 033121003-1, e datës 31.03.2021; Faturës nr. 043021003-1, e datës 30.04.2021; Faturës nr. 053121028-1, e datës 31.05.2021; Faturës nr. 063021002-1, e datës 30.06.2021; Faturës nr. 073121002-1, e datës 10.07.2021; Faturës nr. 083121004-1, e datës 31.08.2021; Faturës nr. 093021002-1, e datës 30.09.2021; Faturës nr. 103021002-1, e datës 30.10.2021; Faturës nr. 113021002-1, e datës 30.11.2021; Faturës nr. 122721002-1, e datës 27.12.2021; Faturës nr. 122721026-1, e datës 27.12.2021; Faturës nr. 013122003-1, e datës 31.01.2022; Faturës nr. 013122035-1, e datës 31.01.2022; Faturës nr. 022822003-1, e datës 28.02.2022; Faturës nr. 033122003-1, e datës 31.03.2022; Faturës nr. 043022031-1, e datës 30.04.2022; Faturës nr. 053122003-1, e datës 31.05.2022; Faturës nr. 063022005-1, e datës 30.06.2022; Faturës nr. 073122003-1, e datës 31.07.2022; Faturës nr. 083122003-1, e datës 31.08.2022; Faturës nr. 091322001-1, e datës 13.09.2022; Faturës nr. 093022031-1, e datës 30.09.2022; Faturës nr. 103122015-1, e datës 31.10.2022; Faturës nr. 103122005-1, e datës 31.10.2022; Faturës nr. 111622001-1, e datës 31.11.2022; Faturës nr. 113022007-1, e datës 30.11.2022; Faturës nr. 113022002-1, e datës 30.11.2022; Faturës nr. 123022001-1, e datës 30.12.2022; Faturës nr. 123022006-1, e datës 30.12.2022; Faturës nr. 013123005-1, e datës 31.01.2023; Faturës nr. 013123034-1, e datës 31.01.2023; Faturës nr. 022823006-1, e datës 28.02.2023; Faturës nr. 022823031-1, e datës 28.02.2023; Faturës nr. 033123018-1, e datës 31.03.2023; Faturës nr. 033123009-1, e datës 31.03.2023; Faturës nr. 041823001-1, e datës 18.04.2023; Faturës nr. 043023005-1, e datës 30.04.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 75/2023, të datës 29.06.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që pas pranimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 86,191.10, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se kreditori dhe debitori në kuadër të bashkëpunimit afarist kanë lidhur kontratë për shërbime, me të cilën kreditori ka pasur obligim pastrimin e hapësirave në objektin ku debitori ushtron veprimtari. Ndërsa, ka theksuar se me datë 03.05.2023, të njëjtit kanë arritur marrëveshje për mënyrën e pagesës së obligimeve që debitori ka pasur ndaj kreditorit sipas faturave. Dhe rrjedhimisht ka shtuar se bazuar në faktin se borxhi që kreditori ka kërkuar të ekzekutohet nuk ka titull ekzekutiv dhe se ky vendim është ndryshuar me një marrëveshje tjetër, ka konsideruar se lejimi i përmbarimit është marrë në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së, duke shtuar se kreditori ka vepruar edhe në kundërshtim me

marrëveshjen pasi që palët janë pajtuar që lidhur me mosmarrëveshjet për përmbushje të obligimit do t'i zgjedhin me bisedime dhe mirëbesim. Në fund ka theksuar se urdhri përmbarimor është lejuar në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së, dhe se nuk ka pranuar kërkesë apo vërejtje paraprake për përmbushjen e obligimit nga ana e kreditorit, ndërsa kreditori nuk ka bashkangjitur asnjë provë që do të vërtetonte se debitori ka dështuar për të paguar obligimet sipas marrëveshjes, meqenëse debitori në vazhdimësi ka qenë duke kryer obligimet sipas marrëveshjes, ashtu siç vërtetohet edhe me fletëpagesat e bashkangjitura si provë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se pavarësisht marrëveshjes debitori ka dështuar që në shumicën e kohës të paguajë me kohë derisa ka stopuar në total me pagesa deri me datë 30 qershor, që nënkupton se ka dal në vonesë 3 javë radhazi, konkretisht në shumë prej EUR 9,000.00. Sa i përket pretendimit se debitori nuk ka pranuar kërkesë apo vërejtje paraprake për përmbushjen e obligimit, i njëjti ka qenë i njoftuar lidhur me datat se kur duhet të përmbushet obligimi, mirëpo edhe përmes email-it të datës 14.06.2023 e ka njoftuar për vonesat e tij në pagesë duke kërkuar realizimin e pagesës. Ka shtuar se ka bashkangjitur edhe analitiken e konsumatorit të Klan Kosova ku vërehen të gjitha faturat e lëshuara, pagesat e realizuara dhe ato të cilat kanë ngecur në realizim. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimi, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datë 11.06.2024 në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesja e autorizuar e debitorit në seancën e mbajtur dëgjimore ka theksuar se qëndron në tërësi pranë prapësimit të paraqitur, ndërsa ka shtuar se detyrimi i debitorit ndaj kreditorit nuk mund të mbështetet në faturat e lëshuara objekt përmbarimi pasi që mes palëve, para inicimit të procedurës përmbarimore, është arritur marrëveshje për mbylljen e borxhit e cila në esencë i ka të gjitha elementet e kontratës për ujdinë e paraparë me nenin 1047 të LMD-së. Andaj, ka theksuar se nga data 03.05.2023, baza juridike për të kërkuar realizimin e pagesave nuk mund të jenë faturat por marrëveshja e palëve e datës 03.05.2024, e cila rrjedhimisht sipas dispozitave të LPP-së, nuk mund të konsiderohet si dokument përmbarimor. Poashtu, përfaqësuesja e debitorit ka shtuar se debitori ka kryer pagesë në vlerë prej EUR 3,000.00 pas inicimit të procedurës përmbarimore dhe se pas minusimit të të gjitha pagesave të realizuara nga ana e debitorit, vlera

e borxhit del të jetë 83,014.22 vlerë kjo tjetër nga ajo e kërkuar për përmbarim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta pranoj prapësimin si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit në seancën e mbajtur dëgjimore ka deklaruar se mbetet në tërës pranë propozimit për përmbarim, duke theksuar se faturat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për të shërbyer si dokumente mbi bazën e së cilave mund të lejohet përmbarimi. Ndërsa, ka shtuar se tani borxhi i debitorit është në lartësi prej EUR 83,191.00, pasi që debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin duke paguar vlerën prej EUR 3,000.00 pas lejimit të urdhrin përmbarimor. Në fund, ka theksuar se fletëpagesat e paraqitura së bashku me prapësim nga ana e debitorit janë pagesa të detyrimeve të cilat nuk janë të përfshira në shumën e kërkuar për përmbarim, fakt ky që mund të vërtetohet edhe nga analitika e konsumatorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr. 75/23, i lejuar me datë 29.06.2023, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori dhe atë në lartësi prej EUR 3,000.00, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë pjesë debitori e ka përmbushur detyrimin. Përkatesisht, gjykata gjen se debitori përmes urdhërpagesës së datës 30.06.2023 me numër të transaksionit 77705864619005, ka paguar në llogari të kreditorit vlerën prej EUR 3,000.00, fakt ky i cili është pohuar edhe nga ana e kreditorit në përgjigje në prapësim, i cili në seancën e mbajtur dëgjimore ka propozuar që urdhri të mbetet në fuqi vetëm për lartësinë e detyrimit prej EUR 83,191.10. Në këtë drejtim, gjykata gjen se prapësimi i debitorit për këtë pjesë të detyrimit është i bazuar, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Meqenëse debitori ka përmbushur pjesërisht borxhin ndaj kreditorit, gjykata në mbështetje të nenit 66, paragrafi 4 të LPP-së, sipas së cilit përcaktohet se: “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, dhe nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: “*Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”, vendosi që për pjesën e përmbushur të detyrimit në lartësi prej EUR 3,000.00, procedura përmbarimore të përfundohej.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr. 75/23, të datës 29.06.2023, për shumën në vlerë prej EUR 83,191.10, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbnimimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbnimimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnimim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbnimjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbnimim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se përmbnimesi privat ka lejuar urdhrin përmbnimimor mbi bazën e dokumenteve të besueshme, përkatësisht faturave të përshkruara si në hyrje të arsytimit të këtij aktvendimi, pasi që të njëjtat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar shërbimet të cilat i janë ofruar debitorit, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbnimje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbnimjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se të njetat fatura janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa të njetat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit dhe nuk janë kundërshtuar më parë. Rrjedhimisht, rezulton e debitori me rregull i ka pranuar faturat objekt përmbnimimi dhe se ka qenë në dijeni për përmbnimjtjen e tyre dhe detyrimin që buron nga të njëjtat.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbnimimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbnimimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbnimim në origjinal.

Gjykata mori parasysh pretendimet e debitorit se baza juridike për të kërkuar realizimin e pagesave nuk mund të mbështetet në faturat objekt përmbnimimi pasi që palët kanë arritur marrëveshje për mbylljen e borxhit, mirëpo të njetat i gjeti si të pabazuara ngase nga marrëveshja interne nuk rezulton se palët janë pajtuar që të mos mund të kërkohet përmbnimimi

sipas dokumenteve të besueshme, përkatësisht faturave të cilat janë objekt përmbartimi. Për më tepër, gjykata sqaron se procedura përmbartimore i nënshtrohet paritmit të rigorozitetit formal mbi bazën e të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat të LPP-së.

Poashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet se urdhri është lejuar në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së, ngase borxhi nuk është bërë i kërkueshëm, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara nga fakti se në secilën prej faturave mbi bazën e së cilave është lejuar përmbartimi është përcaktuar afati i pagesës së detyrimit, rrjedhimisht faturat i përmbajnë të gjitha elemente e përcaktuara në nenin 29.3 të LPP-së, përfshirë këtu edhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Në fund, gjykata mori parasysh pretendimet e paraqitura nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit në seancën dëgjimore ku ka theksuar se pas minusimit të pagesave të realizuara nga borxhi i përcaktuar në marrëveshje mes palëve, del se vlera e mbetur është EUR 83,014.22 dhe jo 83,191.10, mirëpo gjeti se të njëjtat pretendime nuk qëndrojnë pasi që pagesat e realizuara nga ana e debitorit janë zbritur nga borxhi i përgjithshëm i cili buron nga faturat mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbartim dhe nuk janë zbritur nga borxhi lartësia e të cilit është përcaktuar në marrëveshjen interne mes palëve e cila marrëveshje nuk është objekt përmbartimi në këtë procedurë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e tërësisht të urdhrin përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1240/23, datë 12.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.